



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2018

**“MBI PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE KËRKESAVE PËR
INFRASTRUKTURËN E BRENDSHME TË GODINAVE DHE TË
ADMINISTRIMIT TË PIKËS SË AKSESIT NË GODINË PËR RRJETET
E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 20, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë,

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e rregullave dhe kërkesave për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë, për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.
2. Çdo godinë e re duhet të pajiset me pikën e aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.
3. Çdo godinë e re duhet të pajiset me një infrastrukturë të brendshme fizike, të gatshme për komunikime me shpejtësi të lartë deri në pikën fundore për instalimin e rrjetit kabllor (bakër, fibër optike, kabëll koaksial etj.) që mundëson shpërndarjen e shërbimeve broadband me shpejtësi mbi 30 Mbps.
4. Rregullat e parashikuara në pikën 2 dhe 3, do të aplikohen gradualisht për ndërtesat ekzistuese, kur ato janë objekt i punimeve të rikonstruksionit, riparimeve apo rindërtimit dhe punimeve rinovuese të mëdha.
5. Ofruesit e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, me qëllim ndërtimin e rrjetit të tyre deri në pikën e aksesit në infrastrukturën fizike në godinë, duhet të plotësojnë rregullat e mëposhtme:

- a) Identifikojnë një pozicion të përshtatshëm, për një pikë fundore të rrjetit për ndërtesë/godinë ose bllok ndërtesash;
 - b) Sistemi i kanalizimeve duhet të jetë i përshtatshëm me qëllim që të sigurojë që të gjitha pikat fundore të rrjetit, të lidhen me pikën e aksesit;
 - c) Mundësinë e një infrastrukture fizike për një godinë të vetme, ku pika e aksesit të jetë në fasadën e jashtme të godinës dhe të lidhet nëpërmjet kanalizimit në mur me pikën fundore të rrjetit.
 - d) Rrjeti kabllor jashtë godinës do të realizohet nëpërmjet sistemit të tubacioneve nën tokë dhe vetëm në raste të justifikuara përdorimin e linjave ajrore. Sistemi i kanalizimit për rrjetin kabllor, duhet të sigurojë mbrojtje nga kushtet atmosferike dhe integritetin e rrjetit me qëllim vijimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje;
 - e) Godinat me shumë banesa duhet të kenë një pikë aksesi të përbashkët dhe rrugëzime të dedikuara vertikale dhe horizontale, në mënyrë që ofruesit e shërbimit të mund të lidhen nga pika e aksesit në pikën fundore të rrjetit të çdo banese;
 - f) Specifikimet teknike për dimensionin e tubacioneve, rrjeteve kabllore dhe kasetat e pikës së aksesit në godinë miratohen me rregullore nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
6. Këto përcaktime përdoren gjithashtu dhe në komplekset e godinave shumëpërdorimshe, ku përveç banesave rezidenciale, mundësohet dhe përdorimi për qëllime biznesi. Në këtë rast kërkohet një pikë aksesi e përbashkët në funksion të çdo banese brenda ndërtesës. Ndërtesat e tjera të kompleksit mund të përdorin të njëjtën pikë aksesi të përbashkët ose mund të kenë një infrastrukturë fizike brenda godinës krejtësisht të ndarë;
7. Rregullat dhe kërkesat për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë, për rrjetet e komunikimeve elektronike, zbatohen pa cënuar rregullat në fuqi mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së këtyre rrjeteve.
8. Pika e aksesit në godinë, do të administrohet sipas dispozitave të legjisllacionit në fuqi për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.

9. Çdo operatori të komunikimeve elektronike duhet t'i garantohet një e drejtë e barabartë dhe e paanshme për përdorimin e infrastrukturës fizike në godinë të rrjetit të brendshëm të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë deri në pikën fundore.
10. Ngarkohen Autoritetet Planifikuese, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare si dhe, Ofruesit e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA